



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Rishqyrtim të dt.20.12.2021 nga Operatori Ekonomik, **“Muhamet Muçiqi B.I (N.N.P.”Ndërtimtari”)&”Harst Group”Shpk** nga Podujeva, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit **“Mirëmbajtja verore e trotuareve, shesheve dhe hapësirave publike”** me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-5860-2-2-1, nxjerrë këtë:

### VENDIM

**Refuzohet si e pa bazuar** - Kërkesa për Rishqyrtim të dt.20.12.2021, parashtruar nga Operatori Ekonomik, **“Muhamet Muçiqi B.I (N.N.P.”Ndërtimtari”)&”Harst Group”Shpk** nga Podujeva, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit **“Mirëmbajtja verore e trotuareve, shesheve dhe hapësirave publike”** me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-5860-2-2-1, Kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 15.12.2021 të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.

Vërtetohet; Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 15.12.2021, të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.

AK - Ka pezulluar; Aktivitetin e prokurimit me dt.23.12.2021 dhe publikuar për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

AK- Qëndron prapa, Njoftimit për kontratë të Aktivitetit të Prokurimit.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetimi

Operatori Ekonomik, **“Muhamet Muçiqi B.I (N.N.P.”Ndërtimtari”)&”Harst Group”Shpk** nga Podujeva, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit **“Mirëmbajtja verore e trotuareve, shesheve dhe hapësirave publike”** me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-5860-2-2-1, Kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 15.12.2021, Pas analizimit të pretendimit ankimore, AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e pa bazuar dhe se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë.

Më: 20.12.2021, ky OE parashtroi kërkesën për rishqyrtim me pretendimin se:

### **Pretendimi-1:**

Parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim, konsideron se AK dhe komisioni i vlerësimit nuk kanë respektuar dispozitat ligjore të LPP-së lidhur me këtë aktivitet të prokurimit pasi që 137 vendimi, B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së, është nënshkruar nga një zyrtarë e prokurimit por jo edhe nga ZPP ku sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe formularit standard të nxjerrur nga KRPP, këtë vendim dhe këtë formular duhet të nënshkruaj dhe merret vendim nga ZPP-ja.

### **Përgjigjeje:**

AK-Në Zyrën e Prokurimit ka Menaxherin dhe tre zyrtarë të prokurimit të gjithë janë të certifikuar, andaj vendimet i merr AK-ja gjegjësisht Menaxheri i zyrës së prokurimit ndërsa punet administrative në platformën e sistemit të prokurimit të futjeve apo ngritjes të njoftimeve li bëjnë zyrtarët e prokurimit të cilët caktohen nga menaxheri, kur dihet se Raportin e vlerësimit të rekomanduar nga komisioni i vlerësimit e nënshkruan Menaxheri i prokurimit, gjithashtu edhe këtë raport e ka nënshkruar menaxheri dhe ka marrë vendim mbi njoftimin e AK-së. Ndërsa ngritjen në platformë kanë bërë zyrtarët e prokurimit.

Dhe këtu deri më tani gjithnjë kemi vepruar dhe nuk ka patur asnjëherë asnjë ankesë në lidhje me këtë. E as nga ky operator që ka qenë fitues i shumë kontratave në komunën e Podujevës.

Por nëse parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim pretendon diçka që vetëm sa për të bërë kërkesën, duke pretenduar se kemi shkelë Ligjin e Prokurimit Publik.

**Për AK-në, ky pretendim është i pa bazuar .**

### **Pretendimi-2:**

Te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale, nenin 9.1 dhe 9.2 ku kërkesë ka qenë; Për menaxherin e projektit që CV-ja të jetë e nënshkruar nga inxhinjeri e ku dokumentin e kemi ngarkuar në platformën e e-prokurimit lidhur me këtë aktivitet, konsiderojmë se jemi të përgjigjshëm për faktin se edhe për kundër pse cv-ja e menaxherit të projektit nuk është e nënshkruar.

Gjithashtu, AK-Komisioni i vlerësimit i ZPP-së pranë AK-së, që në fillim nuk ka shpallur fitues dhe nuk ka rekomanduar për kontratë por pas ankesës nga OE, AK-ja e aprovon kërkesën dhe lënda kthehet në rivlerësim.

Por gjatë procesit të rivlerësimit ak dhe Komisioni i rivlerësimit nuk kanë respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, konkretisht nenin 59. Par.4 të LPP-së dhe nenin 39 të RRUOPP-së.

### **Përgjigjeje:**

AK- pas kërkesës për rishqyrtim lënden e ka kthyer në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit dhe ekzaminimit të ofertës kemi vërejtë se konzorciumi i OE “**Muhamet Muçiqi B.I (N.N.P.”Ndërtimtari”)&”Harst Group”Shpk** , nuk e ka plotësuar kërkesën e kërkuar nga AK-ja të kapacitetet teknike dhe profesionale të dëshmia e kërkuar dokumentare: **për menaxherin e projektit, CV-ja duhet të jetë e nënshkruar nga inxhinjeri.**

Kjo kërkesë nuk është plotësuar sepse siç e ka pranuar edhe vetë e ka cekë në parashtrimin i kërkesës për rishqyrtim se cv-në, nuk e kam nënshkruar.

### **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:**

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

**Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt, min. 5 punëtorë të rregullt në kompani.  
- Një menaxher të projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtarisë**

**Lista e stafit – e nënshkruar dhe e vëlosur nga OE. ku specifikohen Emrin, Mbiemrin, Profesionin, Eksperienca dhe pozicioni të angazhuar me kontratë apo parakontratë në kompani në afat të projektit.**

drejtimi konstruktiv, me përvojë pune minimumi 3 vite pas diplomimit.

- Për menaxherin e projektit, diploma universitare, CV-a e nënshkruar nga inxhinieri, kontrata ose parakontrata e punës me punëdhënësin valide, vendimi mbi caktimin e menaxher projektit, minimumi dy referencë nga punëdhënësi që ka menaxhuar projekte të ngjajshme.

Bazuar në:

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, te neni 69 i LPP-së se CV-ja është dorzuar por nuk i përmbushë kërkesat, refuzo tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme

Problemi	Si të vepohet?	Neni i LPP-se
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush Kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Andaj Autoriteti Kontraktues ka vepruar në pajtim me nenin 69 të LPP-së dhe se: Ky pretendim i lartë cekur është i pa bazuar.

- Pas analizimit të pretendimit ankimore, AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, konsiderohet se është e pabazuar për arsye se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë.

Nga se u cek, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/1-092, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në institucionet tjera kompetente në pajtim me nenin 109 të LPP-se

Nr. 14-370/03-0109969/21  
Dt. 23.12.2021  
Podujevë



Menaxheri ZP  
Rasim Fejza